



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2020:084245

Datë: 01.10.2020

Numri i dokumentit: 01156441

P.nr.162/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka, procesmbajtësja Suzane Rudi, në rastin penal kundër të pandehurës T.SH nga Fshati. ..., Komuna e Hani Elezit, e akuzuar për shkak të veprës penale në vazhdim Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare” nga neni 437 par 2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, sipas aktakuzës me numër PP/II.nr. 390-13/20 të datës 09.07.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, jo publik, më datë 22.09.2020, në praninë e Prokurores së Shtetit Ajtene Zoni dhe të pandehurës, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 01.10.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura: T.SH nga fshati. ..., Komuna Hani Elezit, e lindur më datë, ..., nga i ati A...dhe e ëma N... e gjinisë Th..., me numër personal ..., me profesion I..., K... e A... Komunale në Han të Elezit, e ve, nënë e tre fëmijëve, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës e Kosovës, mbrohet në liri, e pa gjykuar më parë.

ËSHTË FAJTOR

Sepse në formularin për deklarimin e pasurisë të datës 27.03.2018 dhe 27.03.2019, të dorëzuar në Agjencinë Kundër Korrupsionit në Prishtinë, e pandehura në cilësinë e zyrtares së lartë publike, përkatësisht këshilltare e A..., Komunale në Han të Elezit, në vazhdimësi nuk ka paraqitur saktë pasurinë e pa luajtshme për periudhën nga 1 janar deri 31 dhjetor të vitit 2018 dhe 2019, në atë mënyrë që nuk e ka shënuar që është pronare e 1/1 të njërive kadastrale P-73317079-00501-0 në sipërfaqe prej 128 m², P-73317079-00524-0 në sipërfaqe prej 1096 m², P-7331P-73317079-00585-0 në sipërfaqe prej 2017 m², P-73317079-00611-0 në sipërfaqe prej

252 m², P-73317079-00612-0 në sipërfaqe prej 1008 m², P-73317079-00641-0 në sipërfaqe prej 1175 m², P-73317079-01011-0 në sipërfaqe prej 1839 m², P-73317079-01021-0 në sipërfaqe prej 1835 m², P-73317079-01022-0 në sipërfaqe prej 1690 m², P-73317079-01210-1 në sipërfaqe prej 745 m², P-73317079-01210-2 në sipërfaqe prej 521 m²

Me të cilin veprim ka kryer veprën penale në vazhdim Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare” nga neni 437 par 2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së

Andaj duke u bazuar në dispozitën e lartcekur dhe nenin 22, 41, 45, 46, 50, 51, 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-së dhe nenit 365 dhe 453 të KPPK-së, e:

GJYKON

I. Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditëve (Nëntëdhjetë ditëve), dhe dënim me gjobë në shumë prej 500€ (Pesëqind eurove), të cilat dënime nuk do të ekzekutohet po që se e pandehura në afat prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën gjykata do t’i revokon dënimin me kusht,

II. Obligohet e pandehura që të paguaj shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20 € dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr. 390-13/20 të datës 09.07.2020, kundër të pandehurës T.SH nga Fshati. ..., Komuna e Hani Elezit, e akuzuar për shkak të veprës penale në vazhdim Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare” nga neni 437 par 2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe ka propozuar që të pandehurën ta shpall fajtor dhe t’i shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 22.09.2020.

Seanca nuk ishte publike për shkak të pandemisë Covid 19 dhe vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK-Nr.85/2020, të datës 29 maj 2020

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, e pandehura e pranoi fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës.

Prokurori i Shtetit duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurës ngase i njëjti është bërë konform nenit 248 të KPP-së, dhe i ka propozuar gjykatës që të pandehurën ta shpall fajtores dhe t'i shqipton dënim sipas ligjit.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Pasi që e pandehura ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: E pandehura ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht; Pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurës ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në vazhdim Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare” nga neni 437 par 2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, në mënyrë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Rrethane lehtësuese dhe rënduese

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK -së, dhe gjeti si rrethanë posaçërisht lehtësuese se e pandehura e ka pranuar, rrethana lehtësuese, është kryefamiljare dhe mbajtëse e vetme e familjes, nuk është recidiviste dhe se faktin se pronat e pa deklaruar ua ka bartur pronarëve faktik,

Gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, përpos veprimeve që plotësojnë figurën e veprës penale.

Gjykata të pandehurës i shqiptoi dënim të kushtëzuar duke marrë parasysh faktin se e pandehura ka bërë pranimin e fajësisë dhe ka shprehur pendesë për veprën e kryer, dhe duke u bazuar në të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, gjykata vlerëson se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorëve të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, u detyrua e pandehura që në emër të shpenzimeve procedurale dhe paushallit gjyqësor t'i paguaj kësaj gjykate shumën prej 20.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par 3 pika 3.1 të ligjit Ligji Nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit gjykata e obligoi të pandehurin të paguaj shumën prej 30.00 € Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.nr.162/20 datë 01.10.2020

Procesmbajtësja
Suzane Rudi

Gjyqtari
Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.